


# Aksidentet Rrugore

## Qershor, 2018

**Tiranë, më 23 Korrik 2018** Në muajin Qershor 2018 numërohen 142 aksidente rrugore nga 185 aksidente të ndodhura në Qershor 2017, duke u ulur me 23,2 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Qershor 2014 – Qershor 2018



Në Qershor 2018, numri i të aksidentuarve është 217 persona nga 245 që ishte një vit më parë, duke u ulur 11,4 %. Numri i të aksidentuarve në gjashtëmujorin e parë 2018, është 1.066 duke ulur 11,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në muajin Qershor 2018, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 20 persona nga 12 që ishte një vit më parë. Në gjashtëmujorin e parë 2018, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 98 nga 105 që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në Qershor 2018, aksidentet rrugore, në 79,6 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup moshë 25 – 35 vjeç duke zënë 26,1 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup moshë janë ulur me 14,0 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në gjashtëmujorin e parë 2018, aksidentet rrugore, në 19,7 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 12,7 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Tab. 1 Aksidentet rrugore**

Periudha	Aksidente Gjithsej	Të vdekur		Të plagosur	
		Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Qershor-2017	185	8	4	168	65
Qershor-2018	142	12	8	119	78
Ndryshimi vjetor (%)	-23,2	50,0	100,0	-29,2	20,0
Janar -Qershor2017	899	85	20	763	337
Janar -Qershor2018	801	74	24	659	309
Ndryshimi vjetor progresiv	-10,9	-12,9	20,0	-13,6	-8,3

**Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës**

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Qershor-2017	135	50	7	5
Qershor-2018	113	29	13	7
Ndryshimi vjetor (%)	-16,3	-42,0	85,7	40,0
Janar -Qershor2017	718	181	84	21
Janar -Qershor2018	643	158	77	21
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	-10,4	-12,7	-8,3	0,0

**Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit**

Periudha	Moshë						Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 16 vjeç	16 - 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	
Maj- 2017	1	45	43	30	42	14	10
Qershor-2018	0	37	37	17	31	10	10
Ndryshimi vjetor (%)	100,0	-17,8	-14,0	-43,3	-26,2	-28,6	0,0
Janar -Qershor2017	4	214	254	138	170	67	52
Janar -Qershor2018	6	166	225	137	155	60	52
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	50,0	-22,4	-11,4	-0,7	-8,8	-10,4	0,0

**Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve**

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Qershor 2017	Qershor 2018	Qershor 2017	Qershor 2018	Janar - Qershor 2017	Janar - Qershor 2018	Janar - Qershor 2017	Janar - Qershor 2018
Shqipëria	185	142	12	20	899	801	105	98
Tiranë	75	60	4	5	367	359	22	21
Durrës	26	12	0	0	122	102	9	11
Shkodër	5	4	1	1	26	16	11	14
Elbasan	21	9	1	2	81	53	11	12
Fier	9	18	1	3	47	53	14	12
Vlorë	9	13	1	1	50	55	7	2
Korce	11	4	1	0	40	30	7	2
Lezhë	19	8	2	3	91	68	13	10
Berat	4	5	0	1	23	25	0	3
Kukës	0	6	0	1	19	13	2	4
Diber	3	1	0	1	17	11	0	4
Gjirokastër	3	2	1	2	16	16	9	3

# Përkufizime

**Aksidente:** Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

**I vdekur:** I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

**I plagosur:** I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

**Sjellja e Drejtuesit të Mjetit :** Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, injoron shenjat (sinjalistikën) e trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë etj.

**Sjellja e Këmbësorëve:** Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si : kalim rrugë pa kujdes, etj.

**Burimi i të dhënave:** Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

*Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilësia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.*